

## Akt themelimi

### i

## Shoqërisë

### Illyrian Guard, Sh.A.

Sot më <sup>12</sup> prill 2019, në Tiranë, Shqipëri, në bazë të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 04/04/2019, "Për krijimin e shoqërisë "Illyrian Guard", Sh.A., dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie", vendosa:

#### 1 - Shoqëria

1. Themelimin e shoqërisë tregtare "Illyrian Guard" Sh.A.
2. Shoqëria është person juridik shqiptar, ka formën ligjore të shoqërisë aksionare me ofertë private, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

#### 2 – Selia

1. Selia e shoqërisë ndodhet pranë Akademisë së Sigurisë, në Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë, 1016, Tiranë, Shqipëri.

#### 3 – Qëllimi

1. Shoqëria kryen aktivitete me qëllime fitimi, por pa u kufizuar, në:
  - a. Fushën e rendit dhe sigurisë publike
  - b. Teknologjisë së Informacionit
  - c. Zhvillimit, prodhimit, mirëmbajtjes dhe operimit të sistemeve teknologjike të monitorimit të rendit dhe sigurisë publike.
2. Shoqëria kryen aktivitetet me qëllim ofrimin e shërbimit me kushte më të mira dhe kosto më të favorshme se tregu, për Ministrinë e Brendshme dhe institucionet apo agjencitë në varësi të saj.
3. Shoqëria kryen aktivitete të tjera tregtare me qëllim gjenerimin e fitimeve.

- 
4. Për realizimin e qëllimit të veprimtarisë, Shoqëria mund të bashkëpunojë me persona juridikë dhe fizikë brenda dhe jashtë Shqipërisë.

#### **4 - Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar

#### **5 - Aksionari**

Aksionari i vetëm i Shoqërisë është Ministria Brendshme, për llogari të Republikës së Shqipërisë, me adresë në “Sheshi Skënderbej”, nr. 3, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Ministri i Brendshëm.

#### **6 - Kapitali Themeltar dhe Kontributet në Kapital**

1. Kapitali i Shoqërisë është 100% shtetëror.
2. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.
3. Kapitali themeltar i Shoqërisë është i ndarë në 10 000 (dhjetëmijë) aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej 1 000 (një mijë lekë) secili.
4. Kapitali fillestar i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para dhe zotërohet nga aksionari i vetëm, Ministria e Brendshme.

#### **7- Aksionet**

1. Të gjithë aksionet janë të zakonshme dhe regjistrohen në Regjistrin e Aksionarëve të Shoqërisë.
2. Aksionet janë nominativë dhe të pandashëm. Çdo aksion i jep zotëruesit të tij të drejtën e një vote.
3. Aksionet janë lirisht të transferueshme në çdo moment në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në legjislacionin shqiptar.

#### **8 – Organet e Shoqërisë**

1. Vendimmarrja dhe administrimi i Shoqërisë është strukturuar sipas sistemit me dy nivele, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



2. Organet drejtuese të Shoqërisë janë:
  - a. Asambleja e Përgjithshme;
  - b. Këshilli Mbikëqyrës; dhe
  - c. Administratori.

#### **9 - Këshilli Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të cilët emërohen për një periudhë prej 2 vjetësh, me të drejtë riemërimi.
2. Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës së Illyrian Guard Sh.A zgjidhen:
  - a. Z. Julian Hodaj
  - b. Znj. Elora Kokalari
  - c. Z. Dritan Palnikaj

#### **10 - Administratori**

1. Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej dy vjetësh me të drejtë riemërimi.
2. Administrator i Shoqërisë emërohet z. Henrik Elmazaj.

#### **11 - Eksperti kontabël**

1. Eksperti kontabël i Shoqërisë ka mandat një vjeçar.
2. Ekspert kontabël i Shoqërisë emërohet shoqëria Grant Thornton Albania sh.p.k, rruga Sami Frashëri, kompleksi T.I.D, shkalla B, kati 1, Tiranë, Shqipëri

#### **12 – Të fundit**

1. Ky akt themelimi hartohet dhe nënshkruhet në gjuhën shqipe.

2. Ngarkohet Administratori që të ndërmarrë të gjitha hapat dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e këtij akti themelimi dhe të statutit të shoqërisë sipas parashikimeve të ligjeve në fuqi.

MINISTRI I BRENDSHËM

SANDËR LLESHAJ

